KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
REGIONAL WATER COMPANY
BIFURKACIONI ShA
Ferizaj

Kompania Rajonale e Ujit "BIFURKACIONI SH.A" 1557 FERIZAJ DT. 27.06.2022

Tel. +383 (0) 290 320 650, Tel & Fax. +383 (0) 290 321 119, e-mail: info@bifurkacioni.com, www.bifurkacioni.com

Duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Neni 8.1, Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Nr. 07/2017 dhe Rregulloren mbi Sistematizimin e Punëve dhe Detyrave të Punës të KRU Bifurkacioni ShA Nr.775 të datës 24.12.2007, **Kryeshefi Ekzekutiv i KRU Bifurkacioni SH.A Ferizaj, shpallë:**

KONKURS

Për vendet e lira të punës në KRU Bifurkacioni - Ferizaj:

I. Arkëtues për zonën e shërbimit Ferizaj, tre (3) pozita;
II. Ndihmës Operator në Fabrikën e Përpunimit të Ujit (FPU), tre (3) pozita.

Kushtet:

Për vendet e punës me nr. rendor 1, 2,

-Përgatitja shkollore: Shkolla e Mesme,
-Përvoja e punës, e dëshirueshme.

Përgatitja profesionale, detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

I. Arkëtues:

- Kryen pagesa të faturave të ujit në terren;
- Është përgjegjës për inkasimin e faturave për ujin e faturuar në një zonë të caktuar;
- Në bazë ditore dorëzon mjetet e inkasuara dhe mban përgjegjësi për mjetet e inkasuara deri në dorëzimin e tyre në arkë;
- Është përgjegjës për hartimin e listave dhe rexhistrave të konsumatorëve të cilët nuk janë të rregullt me pagesa;
- Ka për detyrë të përgjigjet dhe të adresojë më tutje në kompani vërejtjet dhe pakënaqësitë eventuale të konsumatorëve;
- Sipas nevojës bën leximin e ujëmatësve;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacionet e programeve Word, Excel dhe Power Point;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit;
- Kryen edhe punë të tjera, me kërkesën e përgjegjësit të tij, të cilit i përgjigjet për punën e të tij.

II. Ndihmës Operator:

- Nën mbikçyrje të Operatorit, bën dozimin e kaugulantëve, flokoulantëve dhe preparateve tjera për neutralizim dhe dezinfektim të ujit;
- Nën mbikçyrje të Operatorit përgatitë në baza ditore tretësirat tjera për përpunimin e ujit përkitazi me recepturën e caktuar nga ana e Përgjegjësit të Kualitetit të Ujit;
- Nën mbikçyrje të Operatorit në raste të jashtëzakonshme (mungesë e energjisë elektrike) bën dezinfektimin përmes tretësirës së përgatitur nga hipokloriti i kaliumit dhe hipokriti i natriumit;
- Përcjellë punën e klimatorëve dhe instalimeve tjera elektrike të cilat shërbejnë për përpunimin e ujit në FPU-në;
- Nën mbikçyrje të Operatorit përditëson evidencat lidhur me sasinë e ujit të prodhuar;
- Merr pjesë në mbrojtjen kundër zjarrit dhe kryen edhe punë të tjera, me kërkesën e përgjegjësit, të cilit i përgjigjet për punën e të tij.

Dokumentet e nevojshme:

-Aplikacioni për punësim – Kërkesa;
-Diploma e përgatitjes shkollore dhe kualifikimeve tjera;
-Ekstrakti i lindjes, jo më i vjetër se 6 muaj;
-Letërnjoftimi fotokopje;
-Vërtetimi se nuk ushtrohet procedurë hetimore nga Gjykata, jo më i vjetër se 6 muaj.

Aplikacioni për punësim merret në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Zyra nr. 1 - KRU Bifurkacioni, ku edhe bëhet dorëzimi i aplikacionit së bashku me dokumentacionin e kërkuar, në zarf-pliko të mbyllur. **Afati i konkursit për aplikim është i hapur 15 ditë,** nga dita e publikimit në ueb-faqen e kompanisë dhe në shtypin ditor, duke filluar **nga data 28.06.2022 e deri më 12.07.2022**, prej orës 9.00 h deri në ora 15.00 h. Telefoni për kontakt 0290 320 – 650.

Ferizaj, 27.06.2022

Kompania Rajonale e Ujit "BIFURKACIONI SH.A" FERIZAJ

Kryeshefi Ekzekutiv

Jeton Shabani